

LYPHASE 36 SL

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

LEJOHET TE PERDORËT VETEM NGA PERDORUES PROFESIONISTE

LYPHASE 36 SL është herbicid me verpim total mbi masen e gjelber, për kontrollin e barerave të keqia graminore nje dhe shumevjeçare, sidomos *Cynodon dactylon*, *Imperata cylindrica*, *Phragmites spp.*, *Cyperus spp.*; sidomos *Chromolaena odorata*, *Lantana camarana*, si dhe barerat e keqia ujore. Pas marrjes nga gjethet, qarkullon me lengjet bimore ne te gjitha pjeset, e veçanerisht ne ato nentokesore.

GRUPI 9 (G)* HERBICID

Lënda aktive: *Glyphosate acid 36 % w/v (48.6 % w/v, në formë kripe izopropylamine).*

Formulimi: *Koncentrat i tretshëm (SL).*

Masat parambrojtëse:

H411: Helmuese për jetën ujore me efekte të zgjatura.

P405+P102: Mbajeni të mbyllur dhe larg nga fëmijët.

P261: Shmangni thithjen e produktit.

P264: Lani duart vazhdimisht pasi ta mbani produktin.

P270: Mos e hani ,pini apo tymosni kur përdorni këtë produkt

P305+P351+P338: Nëse ju bie në sy: Lajini me ujë të bollshëm për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit nëse kenidhe do jetë më e lehtë.

P501: Hidhni përmbajtjen/enën sipas rregullores lokale.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H319: Shkakton acarim serioz të syve. P305+P351+P338: Nëse ju bie në sy: Lajini me ujë të bollshëm për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit nëse keni dhe do jetë më e lehtë.
- Në rast kontakti me lëkurën hiqni rrobat e ndotura dhe lahuni urgjentisht me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Në rast gjëllitjeje mos provokoni të vjella. Dërgoni të sëmurin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën.
- Jepini të dëmtuarit karbon aktiv të tretur në sasi të mëdha uji. Mos i jepni asgjë personit të prekur nëse ka humbur ndjenjat.
- Në rast të thithjes të tretësirës spërkatëse me organët e frymëmarrjes, largoni të aksidentuarin nga zona ku u ekspozua, mbajeni atë të ngrohtë dhe të qetë. Kërkoni këshillë mjekësore.
- Antidot specifik nuk ka, mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

Specie e barerave të demshme	Faza	Doza liter/ha ose %
Barerat nje vjecare graminore dhe gjethe gjera	-ne fazen e mbirjes deri 10 cm lartesi; - Bime ne zhvillim.	1-2 lit ose 2 % 2-4 lit. ose 2 %
Barerat shume vjecare <i>Cynodon dactylon</i>	Ne lulezim	8 lit, pasuar me trajtime plotesuese ne vatra me 3 %
<i>Imperata cylindrica</i>	60-80 cm lartesi	6-8 lit ose 3 %
<i>Panicum maximum</i>	Ne vellazirim te plote os lulezim	6 lit ose 2 %
<i>Paspalum spp.</i>	Ne vellazirim te plote os lulezim	6 lit ose 2 %
<i>Pennisetum spp.</i>	Gjate gjithë stadeve	3-4 lit ose 2 %
<i>Phragmites spp.</i>	Ne lulezim te plote	6 lit ose 3 %
Gjethe gjera shume vjecare	Gjate gjithë fazave	6 lit ose 3% (<i>Convolvulus spp.</i> , 12 lit)
<i>Cyperus spp.</i>	Ne lulezim dhe me pase trajtime me vatra ne vartesi te celjeve te reja	6 lit ose 3 %

Barerat e keqia ujore: Eichhomia crassipes Pistia stratiotes	Gjate gjithë vegjetacionit	6 lit ose 3 %
Shkurre dhe drure shume vjecare	Behen prerje te degeve duke shkatuar plage ne kuroren e pemeve dhe trajtohet brenda 15 minutave.	7 %; trajto perseri pjeset e ritura rrishtaz kur ato kane arritur gjatesine 20 cm.

Vërejtje për përdorimin:

Nuk le mbetje ne toke, prandaj tokat e trajtuara mund te mbillen pak dite pas trajtimit me te gjitha llojet e kulturave pasardhëse. Keshtu ai mund te perdoret per para mbjelljes se perimeve, panxharit, grurit dhe te lashtave te tjera, orizit, livadheve, fidanishteve, farishteve, etj. Trapiantimi i fidanave dhe mbjellja e farerave te behet te pakten 48 ore pas trajtimit.

Shmangni kontaktin e pikave spërkatëse me kulturat e tjera bujqësore. Mos spërkatni ne ditë me erë.

Mos trajtoni ne kulturat, të cilat vuajnë nga strese të ndryshme si thatësia, të ftohtit, etj. Nuk përzihet me produkte të tjera me reaksion alkaline ose acid.

Përdoret ekskluzivisht në kohën dhe për qëllimet e parashikuara në këtë etiketë. Çdo përdorim tjetër do të ishte me rrezik.

Normat maksimale të mëposhtme të aplikimit nuk duhet të tejkalohen nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë për përdorimet specifike tregon se një normë më e lartë nuk çon në ndonjë efekt të papranueshëm për gjitarët e vegjël barngrënës:

- Për përdorim në bujqësi: 1,44 kg glifosat/ha/vit;
- Për përdorim për të kontrolluar barerat e dëmshme në zonat bujqësore dhe jobujqësore: 1,8 kg glifosat/ha/vit;
- Për përdorim në zonat jobujqësore: 3,6 kg glifosat/ha/vit.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret si pas rekomandimeve të mësipërme. Nuk duhet të përzihet me PMB të tjera.

Ndikimi ne ekosistem:

Nuk është helmues për bletët dhe peshqit. Të kushtohet vëmendje e veçantë për:

- bashkëformulantët e pranishëm në produkt, duke marrë parasysh veçanërisht kriteret për identifikimin e bashkëformulantëve të papranueshëm, siç përcaktohet në Urdhrin e Ministrit Nr. 275, datë 5.5.2023, "Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtjen e PMB", të ndryshuar;
- vlerësimin e ekspozimit të konsumatorit në lidhje me mbetjet që mund të jenë të pranishme në kulturat pasardhëse të kultivuara;
- mbrojtjen e ujërave nëntokësore në zonat e cënueshme dhe të ujërave sipërfaqësore, veçanërisht ato që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm, duke marrë parasysh përdorimet specifike në sipërfaqe të mbyllura;
- mbrojtjen e gjitarëve të vegjël barngrënës;
- mbrojtjen e bimëve tokësore dhe ujore jo të synuara, nga ekspozimi me anë të spërkatjes;
- efektet indirekte në biodiversitetin nëpërmjet ndërveprimeve trofike, pasi metodat dhe udhëzimet përkatëse për identifikimin e efekteve të tilla janë miratuar;
- përdorimet nga përdorues joprofesionistë;
- pajtueshmërinë e përdorimeve para vjeljes.

Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, duke përfshirë kombinimet e tyre, sipas nevojës. Në veçanti, zhvendosja do të reduktohet për aplikimet me spërkatje të bëra nga përdorues profesionistë në fushat bujqësore. Si parazgjedhje, për të mbrojtur bimët tokësore jo të synuara, një rrip tampon pa spërkatje në fushë prej të paktën 5-10 m nga kufiri i fushës në varësi të përdorimit të veçantë dhe sprucatorët e zvogëlimit të lëvizjes që reduktojnë lëvizjen e spërkatjes me të paktën 75%, ose do të kërkohen masa të tjera për zbutjen e rrezikut me reduktim ekuivalent të lëvizjes, përveç nëse rezultati i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë për përdorimin e PMB-se tregon se masa të tilla zbutëse të rrezikut nuk janë të nevojshme ose mund të ulen sepse nuk ka rreziqe të papranueshme të shkaktuara nga spërkatja.

Karenca:

Nuk aplikohet.

Magazinimi:

Ruajeni produktin në paketim origjinal të mbyllur, në magazina të mbyllura, të pastra dhe të ajrosura në temperatura ndërmjet +5°C dhe +30°C, larg ushqimeve, ilaçeve, ushqimit për kafshë, plehrave, dezinfektuesve dhe ambalazheve të këtyre substancave. Mbroni nga ngrica dhe rrezet e diellit direkte.

Nr dhe data e regjistrimit: 732/2, datë 31.10.2024;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 5 lit;

Bar kodi përkatës:

Data e prodhimit*Printuar nga makineria në ambalazh;*

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 5 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në ambalazh.;*

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE

Emri dhe adresa e kerkuesit: Vioryl SA. **Adresa:** Km 28 e Rrugës Kombëtare Athinë-Lami, Greqi.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-së: Vioryl SA. **Adresa:** Km 28 e Rrugës Kombëtare Athinë-Lami, Greqi.